



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Continental SHPK" për aktivitetin: "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "Continental SHPK" për aktivitetin: "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211** kundër *Njoftimit për anulim të Kontrates të AK-se të datës 08.04.2021*, të publikuar në Platformën E Prokurimi.

1. Vërtetohet *Njoftimi për anulim i Autoritetit Kontraktues të datës 08.04.2021 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas të njëjtit;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Continental SHPK" me datë 12.04.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sherbime të veçanta kontraktuese për perfaqësim ligjor për nevojat e Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-260-211**

Autoriteti Kontraktues, me datën 15.04.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- Pretendimi i parë është i pa bazuar pasi që fjala tejkallim në këtë rast ka nënkuptuar se ju duhet ta respektoni Tarifen e Odes së Avokateve në limitet e përcaktuara që d.t.th.se çmimet duhet të jenë brenda kufijëve të përcaktuar me të njëjten dhe kjo nuk mund të kuptohet në asnjë rast se kriteri i ri, por kriteri nga FDT-ja. Pra Sa i përket kësaj që në dosjen e tenderit ka qene e parapare që çmimi mos të tejkaloj vlerën e parapare në Rregulloren për tarifën e avokateve dhe nuk ka qene e parapare që çmimi nuk mund të jetë më i lartë se 50% e tarifave të asaj Rregulloreje, kjo çështje është shumë e thjeshtë sepse, Rregullorja e ka patur të normuar tavanin e poshtëm (neni 4 paragrafi 3) që

nuk mund te kontraktoj cmim nen 50% te vlerave ne Rregullore, kurse tavanin e larte e ka lene te lire, qe do te thote se avokatit mund te aplikoj tarifa mbi vleren e rregullores per aq sa mendon vete avokati dhe nuk ka ndonje tavan. Ne rastin e ngjashem per kete kontrate, heren e pare eshte anuluar pse cmimet kane qene te vendosura me te larta se Rregullorja per tarifat e avokateve, andaj edhe pse kjo nuk ka qene e ndaluar ne Rregullore dhe as nuk ka qene ne Dosjen e tenderit, pas ankeses se nje avokateje, OSHP na ka dhene te drejte per anulim te kesaj procedure edhe pse nuk ka qene e parapare ne dosje (mund te merret vendimi I OSHP-se).Pra ketu kemi te bejme me cmime te normuara ne rregullore per tarifat e avokateve, ku ju pretendoni se kjo per qellim mbrojtjen e konkuresnes ne mes avokateve tek rastet e rendomta te perditeshme, kurse nuk po vlejka tek rastet kontraktimit ne institucione publike (dmth konkurenca mund te shkelet ne rastet e kontratave me institucionet publike), qe eshte jashte cdo norme dhe nuk lejohet me asnje dispozite ligjore;

-Eshte i pa bazuar edhe pretendimi se anulimi eshte bere ne kundërshtim me dispozitat ligjore,pasi qe eshte plotësisht e qarte se mosrespektimi i normave ligjore nga ana juaj dhe e tenderueseve tjerë eshte shkelje ligjore qe nuk mund te riparohet me asnjë ndryshim apo veprim ne kete aktivitet.

Poashtu ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar plotësisht nenin 7 duke i trajtuar njejte te gjithë tenderuesit dhe per kete arsye aktiviteti eshte anuluar.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

